



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 347/1 prot.

Tiranë më 28.01.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektvendim.

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 311/1 prot., datë 22.01.2025, administruar me tonën me nr. 347 prot., datë 23.01.2025, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “*Për miratimin e Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit në Republikën e Shqipërisë*” së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Zyra e Komisionerit*”).

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit dhe dokumenteve shoqëruese vërejmë se projektvendimi ka si qëllim që nëpërmjet kornizës të japë udhëzime, përmes një seti rekomandimesh, për institucionet publike se si të përmirësojnë administrimin e proceseve të tyre, duke rritur efektivitetin e sektorit publik në Shqipëri dhe duke përmirësuar shërbimet e ofruara ndaj qytetarit dhe biznesit.

Zyra e Komisionerit konstaton se, projektvendimi i referohet rregullave dhe parimeve bazë mbi mbrojtjen e të dhënave personale, integritetit dhe konfidencialitetit, të parashikuara edhe në akte ndërkombëtare, si Korniza Evropiane e Ndërveprimit (EIF).

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, projektvendimi është hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, e për këto arsye shprehet dakord me miratimin e tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi